



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT
DIREKCIJA URBANIZMA I ŽIVOTNE SREDINE
DIRECTORATE OF URBANISM AND ENVIRONMENT

Tel: 038/200-46012
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr.“Dëshmorët e Kombit” p.n.

DATA/DATUM/DATE	04.01.2023
NR/BR.	04Nr.
PËR/ZATO	z.Agim Aliu, Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	z.Lulzim Aliu, Nënkyetar i Komunës
NGA/OD/FROM	Arbër Bytyqi, Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Plani i punës 2023

Fokusi gjatë kësaj periudhe kohore në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, do të jetë në dinamizimin e punëve në mënyrë që mos të kemi ngecje në hartimin e Hartës Zonale. Plani i punës për vitin 2023 do të ketë keto pika.

1. Perfundimi i shqyrtimit publik të Hartës Zonale dhe miratimi i Hartës Zonale, target për miratimin e Hartës Zonale do të jetë muaji mars i viti 2023.
2. Analizimi i të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarve për Hartën Zonale, që janë deri më tani në Drejtorin e Urbanizmit dhe Mjedisit, në mënyrë që të inkorporohen brenda Hartës Zonal.
3. Përgaditja e raporteve për leje ndërtimore për palët që kanë bërë kërkesë.
4. Përgaditja e raporteve për kushte ndërtimore për palët që kanë bërë kërkesë.
5. Përgaditja e raporteve për leje mjedisore për palët që kanë bërë kërkesë.
6. Përgaditja e raporteve për leje për legalizim për palët që kanë bërë kërkesë.
7. Analizimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjës për qytetarët në lidhje me kërkesat tjera që kanë të bëjnë me Drejtorin e Urbanizmit dhe Mjedisit (kërkesat për pëlqime për shfrytëzim të hapsirës publike, pëlqime për gropim, kërkesa për informata etj.)
8. Fillimi i procedurës për hartimin e planit detal për Jezercin si zonë turistike.
9. Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut “Liria”.
10. Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut “Kodra e Sherreteve”.
11. Takime të rregullta me qytetarë.

Me respekt,